



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK  
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-02/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	28.01.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

### PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dytë (2) të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022 me datë: 28.01.2022, në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. **Shpejtim Gacaferi**: i cili në fillim përshëndeti kryetarin e Komunës: z. Ruzhdi Shehun, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e Kforit, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit.

#### Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK
5. Ermelinda Lolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Lulzim Gacaferi-Anëtar,LVV
14. Eliza Pepshi- Anëtare, LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar,LVV

## Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt.06/12/2021 dhe dt.28/12/2021,
2. Themelimi i Komiteteve të përhershme:
  - 2.1. Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe
  - 2.2 Komiteti për Komunitete,
3. Zgjedhja e përfaqësuesit nga ana e Kuvendit Komunal të Junikut si përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës /AKK/,
4. Prezantimi i Qeverisë Komunale nga ana e kryetarit të Komunës,
5. Të ndryshme.

**z. Shpejtim Gacaferi:** E hapi diskutimin sa i përket rendit të ditës. Kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare nëse dëshirojnë të marrin fjalën. Iu dha fjalën .

**z. Leonard Lolluni:** Falemderit kryesueses përshëndetje për të gjithë të pranishmit, përfaqësuesit e KFOR-it Italian, sa i përket rendit të ditës grupi i AAK-së të pika e parë, ne në mbledhjen e kaluar votuam pro me kushtin që do të na sjelli në mbledhjen e ardhshme procesverbalin, ndërsa ju tek tash e sjellët dhe ne nuk arritëm ta analizojmë, por shpresojmë që herëve të tjera të sjellni me kohë..

**z. Zenel Maloku:** Përshëndetje për të gjithë unë e kam një kërkesë nëse bon si shtesë, rreth lagjes “Agim Ramadani” i kemi 3 probleme si pika të rendit të ditës nëse bënë, nëse nuk bene atëherë të po e lë të pika të ndryshme me e diskutuar, por kërkoj me kusht që me qenë prezent edhe kryetari i Komunës,

**z. Shpejtim Gacaferi:** propozoj që kjo kërkesë të diskutohet në pikën e të ndryshme besoj që edhe kryetari do të jete prezent.

Dhe e hodhi në votim këtë rend të ditës.

**Nga 15 prezent, për ishin 15, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.**

## **Pika e parë e rendit të ditës**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt.06/12/2021 dhe dt.28/12/2021,

**z. Shpejtim Gacaferi:** Sa i përket pikës së parë të rendit të ditës, materialet i keni përpara a ka dikush sa i për këtë procesverbaleve që ka diskutuar dhe nuk i është shënuar diskutimi? E hedhi në votim.

**Nga 15 prezent, për ishin 15, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.**

## Pika e dytë e rendit të ditës

### 2. Themelimi i Komiteteve të përhershme:

#### 2.1. Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe

#### 2.2 Komiteti për Komunitete,

**z. Shpejtim Gacaferi:** Për pikën e dytë sa i për këtë kësaj pike duke u bazuar ne ligjet dhe rregulloret në fuqi jemi të obliguar ti themelojmë këto komitete të përhershme, bazuar ne nenin 35 të statutit të Komunës së Junikut paragrafi 35/1 Kuvendi i Komunës themelon Komitetet e përhershme, te cilat konsideron qe janë komitete të rëndësishme për kryerjen e përgjegjësive të tyre paragrafi 35/2 nëse nuk parashihet ndryshe me ligj apo me rregullore. Komiteti për politikë dhe financa përbëhet prej anëtarëve të kuvendit, atëherë bazuar ne rregulloret qe kemi numri i anëtarëve të komitetit për politik dhe financa duhet ti ketë gjithsejtë pesë (5) mirëpo barazia gjinore duhet të përsihet 50-50, atëherë e kisha hap diskutim për ketë pikë. Kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare nëse dëshirojnë të marrin fjalën. Iu dha fjala .

**z. Sadri Krasniqi:** falemderit kryesues përshëndetje për kryetarin e Komunës, Kforin Italian ju koleg asamblastë bashkëqytetarët, sa i përket kësaj pike grupi i LDK-së sa i përket pesë anëtarëve ne kemi të pa qartë përbërjen ashtu siç e dimë kryesuesi i Kuvendit shkon direkt nga tavolina, po mbesin edhe katër anëtarë e hapi si debat dhe kërkojmë sqarim.

**z. Shpejtim Gacaferi:** siç e that edhe ju kryesuesi shkon direkt edhe është kryesues i Komitetit për politikë dhe financa, ne këtu ne kuvendi i kemi të përfaqësuar nga tri subjekte politike për katër anëtar të kuvendit ju duhet të arrini një marrëveshje qe ti bëni propozimet.

**z. Leonard Lolluni:** Sa i përket Komitetit për politik dhe Financa neve si grup i AAK-së meqë përfaqësohemi në Kuvend aq sa LDK me gjashtë anëtar na takojnë ne ketë komitet ti kemi 2 anëtar, ne nuk mund të barazohemi me subjektin e VV-se, me tre anëtar ne kuvend dhe te barazohemi qe ata të kenë një përfaqësues dhe AAK një përfaqësues, me sa e dimë ne ju keni marrëveshje për bashkëqeverisje dy subjektet LDK-VV, dhe nuk është demokratike as reale të jeni ju dy subjektet politike edhe ne KPF pozitë, ligjërisht na takojnë 2 anëtar sepse po e potencoj edhe një here ne jemi gjashtë anëtar ne kuvend nga radhët e AAK-së.

**z. Lulzim Gacaferi:** Falemderit kryesues përshëndetje për ju kryetarin e Komunës, drejtorët komunal, përfaqësuesit e Kforit, kolegët e mi deputet dhe të gjithë të pranishmit, e kuptoj z. Lolluni se ende i dhemb bashkëpunimi ynë me LDK, ju jeni ata qe ma keni imponuar qe te vi nga gjermania qe të jem pjesë e qeverisjes te punojmë ndershem për qytetarët e vendit tonë me kryetarin Shehu me ju dërguar ne shtëpi qeverisjen e juaj me te keqe 12 vjeçare, por ne nuk kemi marrëveshje koalicioni për asamblenë komunale me LDK.

**z. Leonard Lolluni:** Replikë meqenëse z. Lulzim Gacaferi ma përmendi emrin kryesues unë e njof kapacitetin e Lulzimit dhe nuk dua të lëshohem në diskutime me të.

**z. Zenel Maloku:** Ky komitet nëse ti i merr pese cigare një paqetë te duhanit dhe mi len mu pesë dhe thua se këto te mijat ne peshore thua qe janë më të vlefshme unë po ta pranoj teti ne jemi 6 me 6 nuk pota kundërshtoj me shkua ne KPF, por si rregull duhet me shkuar dy anëtar sepse me ulëse jemi te barabartë ne kuvend a shkon ti apo kënd ta dërgoni neve na takojnë dy dhe grupit të LDK-së i takojnë dy, meqenëse është fillimi i mandatit mos u lëshoni ne këtë punë sepse nuk janë ne te mirën e askujt ne jemi asamble e vogël jo si ne komuna te mëdha, ne jemi anëtar sikur te një familje çdo send qe është ne te mirën e qytetarëve te Junikut ju them kolegeve te mi qe te gjitha projektet ti votojmë sepse ja kemi me borgj këtij vendi.

**Shpejtim Gacaferi:** Falemderit Zenel, ju për mu te gjithë jeni te barabartë ne kuvend dhe e keni vlerën e njëjtë siç e the nëse e qesim ne peshore cigaret prap vlerën për mu e keni te njëjtë .

**z. Sadri Krasniqi:** Kryesues e dëgjova me vëmendje edhe Leonardin edhe Zenelin, këta i kanë kërkesat e veta por rregullorja dhe ligji thonë ndryshe, nëse ti shkon direkt si kryesues atëherë neve na takojnë dy anëtar ne nuk jemi ka kërkojmë diçka me shumë çka nuk na takon, unë e kam një propozim nëse edhe grupi i AAK-se pajtohet qe një anëtar i kuvendit te jete rrotacion ne mes te AAK-se dhe grupit të LDK-se ne nuk po kemi dëshirë t'iu marrim te drejtat qe ju takojnë si po mendojnë këta por bazuar ne rregulloren, unë kam këtë kërkesë.

**z. Zenel Maloku:** Unë siç e thash edhe me herët nëse na takojnë siç e tha edhe kryesuesi me herët qe na takojnë 50 me 50 ne ta dërgojmë një mashkull dhe një femër ashtu edhe grupi i LDK-se një mashkull dhe një femër .

**z. Sadri Krasniqi:** unë propozoj qe një vite ta kemi ne anëtarin ne KPF dhe një vite të jetë anëtar i grupit të AAK-së.

**z. Leonard Lolluni:** Në këtë rast kryesuesi vjen nga radhët e LDK-së, bazuar ne ligjin për vetëqeverisje lokale shkon direkt dhe i takon një gjysë vote atëherë ju si LDK i keni tri vota ne KPF-së.

**Shpejtim Gacaferi:** nëse pajtoheni edhe ju kryetarin i komunës dëshiron ta merr fjalën.

**z. Ruzhdi Shehu:** Përshëndetje kryesues per ju delegat, mysafirët e KFORIT Italian të gjithë të pranishëm, unë propozoj qe për funksionalizmin e mirëfilltë te KPF-se qe të jetë në interesin e të gjithëve propozoj qe grupit të AAK-së, t'iu ipet e drejta qe ti kenë dy përfaqësues grupit të LDK-së një përfaqësues dhe grupit të VV-së një përfaqësues dhe kërkoj qe ky propozim të votohet nga delegatet e kuvendit .

**z. Shpejtim Gacaferi:** Falemderit kryetar atëherë siç e dëgjuat edhe ju propozimin e kryetarit i cili u mundua që të ruhet uniteti, ju grupi i LDK-së a pajtoheni me propozimin e kryetarit.

**z. Sadri Krasniqi:** Ne po pajtohemi me propozimin por le ta kuptojnë grupi i AAK-së sepse nuk ju takon me ligj por për ta ruajtur unitetin po pajtohemi.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Atëherë pres propozimin e një anëtari nga grupi i LDK-së.

z. Sadri Krasniqi: grupi i LDK-së propozon znj. Ermelinda Lllolluni.

**z. Leonard Lllolluni:** Grupi i AAK-së propozon z. Dervish Bajraktarin dhe znj. Rajmonda Krasniqin.

**z. Lulzim Gacaferi:** Grupi i LVV-së propozon z. Xhemë Tofaj.

**z. Shpejtim Gacaferi:** E hedhi në votim këto propozime të juaja për anëtar të Komitetit për politikë dhe Financa këtë përbërje:

1. Shpejtim Gacaferi nga LDK,
2. Ermelinda Lllolluni nga LDK,
3. Dervish Bajraktari AAK,
4. Rajmonda Krasniqi AAK,
5. Xhemë Tofaj LVV.

**Nga 15 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, një abstenim, kalon.**

**Shpejtim Gacaferi:** Kalojmë të përbërja në Komitetin për Komunitete edhe ky komitet duhet të ketë përbërjen prej pesë anëtareve 50% nga gjinia femërore dhe 50% nga gjinia mashkullore, pasi që ne Junik nuk ka komunitet të tjera përveç shqiptarë, një pjesë të zgjidhët nga anëtarët e kuvendit dhe një pjese plotësohet nga grupet fetare tarikati dhe sunitë me nga një përfaqësues, unë propozoj që nga tri subjektet politike në Kuvendi të përfaqësohen me anëtare femra dhe nga përfaqësuesit fetar të përfaqësohen dy anëtar meshkuj.

**z. Zenel Maloku:** Ky komitet për komunitete në mandatin e kaluar nuk kemi pasur anëtar nga komuniteti fetar, ata përfaqësues kanë aktivitetet të veta në xhami dhe në teqe në këtu jemi në asamble komunale, ju si grup i LDK-se nëse keni dëshirë dërgoni në këtë komitet shejh apo hoxhë nuk ju mohojmë por në si grup i AAK-së a e dërgojmë nga mrenda apo nga jashtë në do të dërgojmë dy anëtar në këtë komitet sepse na takojnë mashkull dhe një femër me rregullore.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Shumica e anëtarëve të komitetit përbehet nga anëtarët jashtë kuvendit por në këtë rast shumica e anëtarëve po na bjen që të jetë nga Kuvendi por tek qelësi 3 duhet të jeni nga kuvendi dhe dy anëtar nga jashtë kuvendit, po pres propozime nga ju.

**z. Sadri Krasniqi:** Është e vërtet se mandatin e kaluar ka qenë kështu por para tetë viteve përfaqësimi ka qenë vetëm dy anëtar nga kuvendi dhe anëtarët e tjerë kanë qenë nga jashtë kuvendi e njëjta formë edhe ne mendojmë se është drejte që ti kemi përfaqësim jashtë kuvendit anëtarët e tjerë pasi që ju takojnë komunitetit.

**Lulzim Gacaferi:** Grupi i LVV-së pajtohet me propozimin e juaj që anëtarët e komitetit fetar janë të domosdoshëm të jenë pjesë e komitetit të komuniteteve, unë besoj që edhe z. Maloku do ta kuptoj me vonë se janë të domosdoshëm anëtarët nga komuniteti fetar.

**z. Zenel Maloku:** ne si grup i AAK-së mbesim në propozimin e me hershem që ti kemi anëtar një femër dhe një mashkull, sepse në mandatin e kaluar kanë qenë të gjithë anëtar të kuvendit.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Nuk jemi duke mohuar të drejtën por shumica e anëtarëve të këtij komiteti duhet të jetë i përfaqësuar nga jashtë Kuvendit sepse është rregulluar me ligje në fuqi, në shumicat e Komunave kanë komunitete jo shumicë sepse ky komitet ju takon atyre, por në Komunën e Junikut nuk ka komunitete jo shumicë, por duhet të themelohet ky komitet bazuar në ligjet në fuqi duhet të themelohet dhe tre anëtar duhet të jenë nga kuvendi dhe dy të tjerë nga komuniteti fetar. E Hedhi në votim qelësin nga tri subjektet politike të jenë nga një anëtarë femër dhe nga komuniteti fetar të jenë dy anëtar meshkuj.

**Nga 15 prezent, për ish-in 9, asnjë kundër 6, një abstenim, kalon qelësi.**

**z. Sadri Krasniqi:** Grupi i LDK-së propozon znj. Zejnepe Gaxherri për anëtare të Komitetit për Komunitete.

**Z. Leonard Lllolluni:** Grupi AAK-së meqenëse në votuam kundër qelësit nuk kemi propozime.

**z. Luzim Gacaferi:** Grupi i LVV-së propozon znj. Eliza Pepshi.

**z. Ruzhdi Shehu:** Po kërkoj nga grupet politike të përfaqësuesar të kenë një mirëkuptim për grupet e komuniteteve fetare, ata duhet të jenë pjesë e komitetit të komuniteteve pasi që do të diskutohen dhe trajtohen tema të ndryshme problemet dhe sfidat e ndryshme të cilat na presin në të ardhmen, kërkoj mirëkuptim nga ju që ta respektoni këtë qelës në të mirën e interesave të përgjithshme ta propozoni anëtarin femër që të plotësohet ky komitet, pasi që edhe në komitetin për politikë dhe financa ishte e mundshme që të bëhet kompromisi në funksion të unitetit dhe të tejkaluar me sukses dhe ju përgëzoj, kërkoj nga grupi i AAK-së që ta shqyrtoj edhe njëherë kërkesën që ta propozoj kandidatin e tyre, ti respektoj këto dy sekte pasi që janë të domosdoshëm për funksionalizimin e përhershëm në komitetin për komunitete dhe do të tregojmë performancë të mirë në të mirën e të gjithëve dhe në veçanti të Kuvendit

**z. Leonard Lolluni:** Kërkoj qe grupi i AAK-së të bëjë një konsultim prej pesë minutash pauzë. Meqenëse ligji decidivisht e thotë qe shumica qe të jetë shumica nga kuvendi ne si grup nuk jemi kundër komunitetit fetar, por ne propozojmë qe z. Zenel Maloku të jete dy vite dhe znj. Erleta Qestaj dy vite ne vazhdim si rrotacion siç e ceku me herët z. Sadri Krasniqi.

**z. Shpejtim Gacaferi:** unë po kërkoj qe dy vitet e para ta caktoni znj. Erleta Qestaj si propozim i juaji pastaj me marrëveshje me bo zëvendësimin me gjininë mashkullore ju mundeni ne grup te juaj mund ti propozoni ndryshimet e anëtarëve të juaj .

**z. Leonard Lolluni:** Kryesues ne si grup i AAK-së e kemi dakordim qe të gjithë përfaqësuesit për komitete dhe komisione te zgjidhen ne bazë te numrit te votave te cilat i kanë ne këtë rast z. Zenel Maloku në AAK është personi me i votuar dhe si matematik ne këtu e kemi problem kryesor.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Nuk po shoh asnjë problem as tek z. Maloku, as të znj. Qestaj por si fillim ta respektojmë rregulloren, a mundemi të shkojmë me propozim për znj. Erleta Qestaj.

**z. Zenel Maloku:** unë po mendoj se nuk e kom te qartë se cka po kërkon ne komitetin për politikë dhe financa i ki dy anëtare femra ndërsa ne komitetin e komuniteteve i ke po ashtu dy femra.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Po kërkojë qe të përfaqësohemi si pas rregullores në fuqi nëse bëme shkelje, arsyeja qe bëme shkelje ishte të grupi i juaj mos te dalim keq.

**z. Leonard Lolluni:** Shkelja nuk erdhi nga grupi i AAK-së por sepse grupi i VV-se mujti ta dërgoj anëtares femër.

**z. Lulzim Gacaferi:** Replikë ti z. Lolluni nuk ki kompetenca te diskutosh ne emër të LVV-së, unë jam përfaqësues i saj .

**z. Dervish Bajraktari:** Grupi i LDK-se qe i dërgoj një femër një mashkull ashtu edhe grupi i AAK-së i dërgoj një femër një mashkull për anëtar të KPF-së mos te mbetet faji te grupi i janë.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Grupi i LDK-së e dërgoj veç një anëtar femër, por kryesuesi shkon direkt, unë mendova qe do të arrini kompromis, edhe pse u munduat te kontribuoni por nuk arritët, vazhdojmë me propozimet të cilat i kemi :

**znj. Zejnepe Gaxherri nga radhët e LDK-së,**

**Nga radhët e AAK-së nuk kemi gatishmëri qe te kemi anëtarë të kuvendit femër,**

**Znj. Eliza Pepshi nga radhët e LVV-së,**

**Nga Tarikati një anëtar do ta dërgojnë si emër,**

**Nga Komuniteti fetar Suni një anëtar do ta dërgojnë si emër.**

Ndërsa mbetet edhe një anëtar i jashtëm, unë ju beje thirrje që ta propozoni një anëtarë të Kuvendit gjini femërore që të kontribuon në këtë komitet nuk po e shoh si problem.

**z. Leonard Lolluni:** Kryesues përfaqësuesi i jashtëm a mundet me qenë femër të ju mbetet juve zgjedhja.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Nëse komitetit fetar nëse ju themi të dërgojnë anëtarë femër është pak me e vështirë ne e çmojmë shumë gatishmërinë e tyre që na respektojnë me delegimin e anëtarëve të tyre në këtë komitet për komunitete.

**z. Zenel Maloku:** Edhe njëherë tha ne si grup i AAK-së e kemi prurë vendim emrin anëtarit e kemi delegu dhe po kërkoj që ta miratoni nëse jo vazhdoni pa ne.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Tha grupit të AAK-së ju dham mundësinë e delegimit të anëtares femër për këtë Komitet, kemi afat prej 30 ditëve për funksionalizimin e këtij komiteti prap presim nga ju që përfaqësoheni edhe ju me anëtarin e juaj që të dalim mirë, nëse ju nuk dëshironi atëherë ne do ta gjejmë një anëtar tjetër. vazhdojmë me propozimet të cilat i kemi :

znj. Zejnepe Gaxherri nga radhët e LDK-së,

Znj. Eliza Pepshi nga radhët e LVV-së,

Nga Tarikati një anëtar do ta dërgojnë si emër,

Nga Komuniteti fetar Suni një anëtar do ta dërgojnë si emër.

**Nga 14 prezent, për ishin 9, kundër 5, asnjë abstenim, kalon .**

**Pika e tretë e rendit të ditës**

**3. Zgjedhja e përfaqësuesit nga ana e Kuvendit Komunal të Junikut si përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës /AKK/,**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Kemi një kërkesë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, ku është kërkuar që ta dërgojmë një emër në këtë institucion Kuvendit i takon një përfaqësues por Kryetari i Komunës z. Ruzhdi Shehu ka biseduar me ta dhe e kanë aprovuar që ne të kemi dy përfaqësues, ky kuvend zgjedhet një herë në katër vjet.

**z. Sadri Krasniqi:** Grupi i LDK-se propozon znj. Lirjeta Shehun.

**z. Leonard Lolluni:** Grupi i AAK-së propozon z. Dervish Bajraktarin.

**z. Shpejtim Gacaferi:** E hedhi në votim.

**Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.**

#### **Pika e katërt e rendit të ditës**

##### **4. Prezantimi i Qeverisë Komunale nga ana e kryetarit të Komunës,**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Për këtë pikë fjalën e kaloj të kryetari i Komunës së Junikut z. Ruzhdi Shehu.

**z. Ruzhdi Shehu:** Sa i përket qeverisë Komunale baza kryesore imja ka qenë që të kemi një qeveri me përvojë dhe kualifikime akademike të gjithë të emëruarit janë me përgatitje akademike edhe me master, do të filloj nga nënkryetari i Komunës:

**z. Besart Tofaj -Inxhinjer i Teknologjisë Informative-Nenkryetari i Komunës,**

**z. Xhavit Velijaj-Drejtor për AKRS- Inxhinjer i Makinerisë,**

**znj. Vjloca Qestaj -Drejtoresh për Buxhet dhe Financa-Magjister e burimeve njerzore**

**z. Zenun Shala-Drejtor për Urbanizem Kadaster dhe Mjedis- Inxhinjer i Makineris,**

**znj. Gentiana Tofaj-Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik- Fakulteti Filologjik Dega Gazetari**

**z. Demokrat Ganijaj- Drejtor për Shërbime Publike dhe Inspeksion-Jurist i Diplomuar,**

**znj. Leonora Shehu- Drejtoresh për Administratë e përgjithshme -Juriste e diplomuar,**

**z. Fatos Shala-Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale -Fakulteti i Gjuhës angleze.**

Kjo është përbërja e qeverisje Komunale sa për ti informuar kuvendin shpresoj që do të jemi bashkëpunues edhe me kuvendin pa dallim në adresimin e kërkesave në interesin e të gjithë qytetarëve pa dallim të Komunës së Junikut, unë po e përsëris sa i përket barazisë gjinore sidomos të komitetet e përhershme dhe po kërkoj nga grupi i AAKS-së ta dërgojë përfaqësuesin e tyre, edhe njëherë e falënderoj kuvendin të gjithë delegatet të punojmë së bashku gjithmonë duke i respektuar rregulloret dhe ligjet në fuqi.

#### **Pika e pestë e rendit të ditës**

##### **5. Të ndryshme,**

**z. Shpejtim Gacaferi:** sa i përket kësaj pike a ka diskutime.

**z. Zenel Maloku:** ne i kemi disa probleme ne lagjen "Agim Ramadani" meqenëse e kemi edhe drejtorin e Shërbimeve Publike e uroj për marrjen e detyrës së se është makinë e cila bene zhurmë te mërzitshme e cila prish qetësin e gjithë qytetarëve te lagjes me zhurmën te cilën e krijon për bluarjen e druve e pa përballueshme, problemi tjetër te kanalizimi i ujërave te zeza qe është bllokuar puseta, secilën dite është duke u vështirësuar qe do te sjelle telashe shume te mëdha nëse nuk intervenohet, çështja tjetër është kur behet kyçja për dalje ne rrugë është shitore gërmadhë ku duhet te pastrohet urgjentisht sepse po krijon rrezik dhe duhet te intervenohet urgjentisht dhe nuk ka pengesa nga pronari pasi ajë është vetëm një gërmadhë.

**z. Lulzim Gacaferi:** po pajtona plotësisht me z. Malokun sepse ne lagjen "Agim ramadani" zhurmat apo alarmet e fabrikës qe po prodhojshin pelet nëse nuk gaboje, duhet te vërtetohet se a ka leje për ushtrimin e veprimtarisë. Gjithashtu deshta të lidhem te tema e arsimit meqenëse drejtori i Arsimit **z. Xhavit Velijaj** si e kemi gjendjen ne arsim sepse sipas informacione qe kemi janë rreth 200 nxënës dhe personel te infektuar me virusin COVID-19, çfarë veprimesh keni marr masat e nevojshme për gjendjen e krijuar a janë dezinfektuar shkollat për parandalimin e pandemisë? Deshta te ndërlihem edhe te ndërtimi i shkollës meqë e njoh atë fushe te ndërtimit fasadimi dhe punët të cilat janë realizuar nga kompania kam vërejt mangësi shumë mëdha, kisha kërkuar nga ju ti merrni masat e duhura me ministrinë përkatëse qe ndërtimi dhe punët te realizohen sipas standardeve të duhura qe mos te ketë probleme në të ardhmen. Po kaloj edhe Qendra e Mjekesisë familjare e kuptoj qe është gjendje te vështirë por dr. Ali Kuqi ka bere një menaxhim te shkëlqyer por sa i përket pajisjeve mjekësore ka mungesë te madhe te barnave elementare z. Shala kërkoj nga ju qe te na jepni informacione se ai keni shfrytëzuar hapësirën e menaxhimit për gjendjen e krijuar dhe ti furnizoni me medikamente qe qytetaret e Komunës se Junikut te kenë shërbime te cilat i meritojnë.

**z. Lenord Ljolluni:** falenderit kryesues meqenëse më ka ra ne sy zhvendosja e pikturës qe e pasqyron kuvendin e Junikut qe i ka parapri kuvendit te shpalljes se pavarësisë së Shqipërisë qe është organizuar 100 vjetori i Kuvendit të Junikut në Asamblenë Komunale.

**z. Dervish Bajraktari:** Një pyetje për Drejtorin e shërbimeve Publike meqenëse jemi ne sezonin e dimrit në lagjen bajraktar e kam një kërkesë qe ti kushtohet vëmendje ne lagjen bajraktar, pasi qe ka akull shumë te madh. Unë ju kam parë një dite duke larguar borën por kisha kërkuar qe ti kushtohet vëmendje me e madhe, si dhe te "Kroni i Madh" rrugës një kanalizim qe rrjedh uji gjithë kohen kërkoj te merren masa për evitimin e problemit.

**z. Xhemajl Tofaj:** Kisha kërkuar informatë për mirëmbajtjen e rrugëve lokale nuk e kemi informatën a është berë ne formë tenderi apo me pune vullnetare?

**z. Ruzhdi Shehu:** Sa i përket pyetjes se z. Malokut për punët qe janë duke u zhvilluar ne ish fabrikën e tekstilit për përpunimin e peletit, ne kur kemi ardhur kemi gjetur duke punuar, kemi filluar te monitorojmë funksionalizimin e kësaj fabrike se a bjen ndesh me prishjen dhe rendin e ambijentit po më vjen mirë që e keni ngritur si çështje te cilën është dashtë ta ngritni me herët ne

kemi marrë të gjithë hapat sipas legjislacionit që janë në fuqi, sa i përket kanalizimit është në prioritetin tonë që ta trajtojmë në kohën me të shkurtër por jemi në sezonin dimrit dhe ka lagështi shumë të mëdha gjatë reshjeve të mëdha për të evituar problemin e krijuar, sa i përket dyqanit ne do të shikojmë mundësitë bashkë me drejtorët që të bëhet një hulumtim dhe do të merren masat për ta trajtuar edhe këtë problem. Sa i përket arsimit pyetje me vend që ngriti nga z. Gacaferi, ne i kemi marrë të gjitha masat sa i përket menaxhimit të pandemisë është e vërtetë se ka numër të infektuar, por shkollat i kemi në skenarin C mësim në distancë (online) personeli arsimor janë duke punuar sipas planit të programeve të parapara, janë formuar Task forcat në kuadër të shkollave, ku jemi në bashkëpunim të ngushtë për të vlerësuar gjendjen sipas rekomandimeve nga IKSHP-ja dhe Ministria e Shëndetësisë, gjithashtu kemi formuar shtabin emergjent në kuadër të Komunës së Junikut. Sa i përket shëndetësisë tani e kemi drejtorin ku është duke skenuar gjendjen kemi pasur mungesë të mjekeve kemi marrë përkrahje nga Ministria e Shëndetësisë edhe me mjek dhe me furnizime me doza të vaksinave, qytetaret e Junikut janë vaksinuar por po kërkojë edhe nga ju që të apeloni të familjarët e juaj që të vaksinohen, pasi që në këtë kohë kemi një numër të madh të infektuar të qytetarëve.

Ndërtimi i objektit të ri të shkollës menaxhimin e punëve e ka në mbikëqyrje Ministria e Arsimit, ditën e parë që kemi ardhur kemi vu kontaktet me Ministrinë e Arsimit dhe jemi njoftuar me punët që janë duke u realizuar, kemi sugjeruar që punët të kryhen sipas kontratës dhe afateve të parapara. Pastrimi i rrugëve lokale nuk kemi gjetur kontratë me asnjë kompani por jemi duke realizuar pastrimin në formë vullnetare dhe me pajisjet të cilat i kemi në dispozicion me njësinë e zjarrfikësve, për ne ka qenë mungesë e madhe që në sezonin e dimrit nuk kemi gjetur kontratë për mirëmbajtje të rrugëve lokale në sezonin e dimrit, duke falënderuar bizneset vullnetarët njësinë e zjarrfikësve për pastrimin e borës. Në vitin e ardhshëm ne do të kemi kompaninë e kontraktuar të specializuar që merret mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve lokale për sezonin e dimrit. Është e vërtetë që ka pas akull të madh por kemi marrë zotime nga kompanitë që menaxhojnë rrugët regjionale që do ta bëjnë kryposjen e rrugëve. Sa i përket kanalizimit të rrugës e bajraktarëve ne kemi skenuar gjendjen ai problem është krijuar moti dhe ne do ta evitojmë problemin në kushtet e vullnetare kur të krijohen, besoj që edhe ne të ardhmen do të trajtojmë të gjitha bashkë dhe do të adresojmë në zgjidhjen e tyre.

**z. Shpejtim Gacaferi:** falemnderit kryetar për shpjegimet që i dhe në emër të drejtorëve, z. Lllolluni sa i përket fotografisë së 100 vjetorit të Kuvendit një pikturë e mirë, por me gjithë ata ka qenë kopje jo origjinale ka qenë kërkesë e autorit që të hiqet mos të keqpërdoret i cili ka thënë që është mashtruar dhe pagesa nuk i është bërë asnjëherë ka kërkuar që mos të keqpërdoret deri të kryhen obligimet, në momentin kur të kryhen obligimet e pagesës ne do ta vendosim aty ku ka qenë.

**z. Leonard Lllolluni:** falemnderit kryesues për sqarimet, unë nuk e kam pasur informatën se Komuna ka obligime të pa realizuara lidhur me pikturën e 100 vjetorit të Kuvendit për Autorin, një pyetje edhe për kryetarin e Komunës nëse me lejohet në si komune me planin zhvillimor komunal si prioritet zhvillimin e turizmit, deshta të di edhe nga kryetari i komunës a e ka prioritet zhvillimin e turizmit i di mire kapacitetet e buxhetore të Komunës meqenëse tetë vite kam shërbyer

ne drejtorinë e zhvillimit Ekonomik është vështirë me punuar me atë buxhet kisha sugjeruar me trokit ne dyert e donatorëve qe operojnë ne Kosovë, nuk e di aje ne dijeni për operatorin ekonomik Kroat qe biznesin e tij e ka regjistruar ne Republikën e Kosovës si lëshim i lirë ky operator me te gjitha sfidat ka arrit me qe shërben ne bjeshkët e Junikut qe pesë vite, unë nuk po kërkoj qe kryetari mi përkrah me buxhet por te paktën mi përkrah moralisht, ata çka kërkojnë qe rruga ne “Stanishten e Goqajve” mos te hapet me eskavator deri ne gropën Erenikut.

**z. Ruzhdi Shehu:** Ky operator ka kërkuar të takohemi, por ne na ka munguar informacioni apo një raport i shkruar lidhur me aktivitetin qe e realizon ky operator, unë jam i gatshëm ti pres dhe te takohem ne çdo kohë sepse edhe ne prioritetin tim është zhvillimi i Agro-Turizmit.


**z. Zenel Maloku:** Te shëndetësia kur kemi seanca të kuvendit qe njëherë ne muaj qe informatat qe i kemi lidhur me shëndetësi te vjen një mjek profesional qe përgjigjen ta kemi nga profesionisti nuk jam kundër nga drejtori i emëruar ne ketë pozitë por është kërkesë e imja.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Ne nuk do të ndërhyjmë të përzgjedhja e Kryetarit sa i përket emërimeve, kur paraqitet kërkesa për informatat për shëndetësi, do ti kesh informatat e nevojshme . E shpalli të mbyllur mbledhjen e dytë të Kuvendit Komunal në Junik, ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:00.

Procesmbajtësi:

z. Arton Krasniqi



Kryesuesi:

z. Shpejtim Gacaferi

